

URDHËR
Nr. 64, datë 7.8.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; si dhe të VKM-së nr. 395, datë 13.5.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësim”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, drejtorit të Kontrollit të Dokumentacionit dhe Vlerësimit, z. Alban Marku.
 2. Kompetencat e titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin do të ushtrohen për periudhën nga data 11.8.2025 deri në datën 22.8.2025.
 3. Nuk delegohen kompetenca të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
 4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Alban Marku, drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Dokumentacionit dhe Vlerësimit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Katriot Gura